



**VENDIM MBI ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

Data e miratimit: 29 prill 2021

Nr. i lëndës: 2019-01

G.T.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 29 prill 2021, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Z. Petko PETKOV, anëtar zëvendësues
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Kjo ankesa është regjistruar më 1 gusht 2019.
2. Ankuesja kërkoi që mos t'i zbulohet identiteti i saj. Duke marrë parasysh çështjen, në veçanti rrethanat e lëndës, Paneli është i bindur që kërkesa duhet të pranohet.
3. Me letrën e datës 5 gusht 2019, Paneli informoi Misionin për Sundimin e Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX-in Kosovë ("Misioni") se kjo lëndë ishte regjistruar në Panel.

4. Më 16 tetor 2019, Paneli kërkoi nga ankuesi që të sigurojë informacion shtesë në lidhje me ankesën.
5. Më 29 tetor 2019, ankuesi paraqiti informacion shtesë.
6. Më 26 nëntor 2019, Paneli i dërgoi Misionit një Deklaratë të Kërkesave dhe Pyetjeve, duke e ftuar që të parashtronte përgjigje dhe vërejtje me shkrim mbi ankesën jo më vonë se me datën 26 janar 2020.
7. Paneli pranoi vërejtjet e shefit të Misionit më 18 shkurt 2020.
8. Me një letër të datës 19 shkurt 2020, ankuesja u ftua t'u përgjigjej parashtrimeve të Misionit nëse ajo dëshironte ta bënte këtë.
9. Më 12 mars 2020, ankuesja paraqiti vërejtjet e saj mbi parashtrimet e Misionit.
10. Më 4 qershor 2020, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 3 (ndalimi i torturës, trajtimin ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës) dhe 8 (e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare, vendbanimin dhe korrespondencën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa") (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2020-06-04%20Admissibility%20Decision%202019-01%20signed-a.pdf>).
11. Më 3 gusht 2020, Paneli pranoi parashtratat e ankuesit rreth meritave.
12. Më 7 gusht 2020, Paneli i transmetoi këto Misionit për informacion.
13. Më 1 tetor 2020, Paneli pranoi parashtratat e Misionit rreth meritave.
14. Më 28 tetor 2020, Paneli i transmetoi këto tek ankuesja për informacion.
15. Më 11 dhjetor 2020, Paneli lëshoi Vendimin dhe Gjetjet e tij në lidhje me meritat e lëndës ([2020-12-11 Vendimi dhe Gjetjet 2019-01-signed.pdf \(hrrp.eu\)](#)). Në atë vendim, Paneli gjeti që Misioni kishte shkelur të drejtën e ankuesit sipas Nenit 3 të Konventës në një masë të kufizuar, siç përshkruhet në atë Vendim. Paneli gjithashtu ftoi Misionin të marrë parasysh rekomandimet e mëposhtme:
 - i. Pranimi që sjellja e tij kontribuoi në shkeljen e të drejtave të ankuesit; dhe
 - ii. Të kontaktohen ankuesi dhe autoritetet vendore për të vërtetuar nevojën për siguri shtesë që del nga dëshmia e ankuesit në Serbi.

Paneli gjithashtu i kërkoi ShM-së që t'ia shpërndajë vendimin e tij zyrtarëve përkatës të Misionit dhe autoriteteve jashtë tij.
16. Në vendimin e lartpërmendur, Paneli kërkoi nga Misioni që të raportojë përsëri mbi zbatimin e rekomandimit jo më vonë se me datën 28 shkurt 2021.
17. Me anë të një letre të datës 29 mars 2021, Misioni informoi Panelin për masat e marra në përgjigje të rekomandimeve të Panelit.
18. Në përputhje me rregulloren 45 e *tutje* të rregullores së tij të punës, Paneli do të shqyrtojë parashtratat e Misionit në lidhje me zbatimin e tij të rekomandimeve të Panelit.

II. FAKTET

19. Faktet e lëndës, siç paraqiten nga parashtresat e palëve mund të përmbliidhen si më poshtë:
20. Ankuesja mori një thirrje nga një gjykatë në Kosovë për t'u paraqitur si dëshmitare në një seancë penale që po zhvillohej diku në vitin 2019 në një gjykatë në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejshëm "Serbia"). Këto procedura penale kishin të bënin me krime të rënda që dyshohej se ishin kryer gjatë konfliktit në Kosovë në vitet 1998-99. Ankuesja më parë kishte dhënë deklaratat të dëshmitares, përfshirë edhe në Mision, në lidhje me të njëjtat ngjarje.
21. Pak kohë pasi ankuesja kishte pranuar thirrjen dhe para datës së caktuar të seancës dëgjimore, Misioni kontaktoi ankuesen në lidhje me thirrjen dhe udhëtimin nga vendbanimi i saj në Kosovë për në Serbi për të dëshmuar në seancë.
22. Misioni më pas organizoi transportin dhe shoqëroi ankuesen në Serbi diku në vitin 2019.
23. Misioni gjithashtu përzgjodhi akomodim tjetër në Serbi për ankuesen kur u gjet se akomodimi i ofruar nga autoritetet serbe ishte i papërshtatshëm. Misioni kishte sjellë së bashku një mjek shqipfolës, pasi këto masa paraprake i kishte parë të nevojshme.
24. Sipas ankueses, ajo ishte kërcënuar dhe frikësuar përderisa ishte në Serbi dhe më pas edhe në shtëpinë e familjes së saj në Kosovë, si rezultat i dëshmisë së saj në Serbi. Ankuesja vuan nga trauma si rezultat i këtij frikësimi.
25. Paneli thekson se kur bënte konstatimin e shkeljes së të drejtave të ankueses nga Misioni sipas nenit 3 të Konventës, Paneli vuri në dukje se kontributi i Misionit në dëmin e pësuar nga ankuesja ishte i pjesshëm, duke marrë parasysh ekzistencën paraprake të cenueshmërisë së ankueses, mirëpo serioze në bazë të mandatit të sundimit të ligjit të Misionit dhe besimit të dhënë nga ankuesja aty. Duke arritur në përfundimin se ky dëm plotësonte prapë e ashpërsisë së vuajtjeve të kërkuar sipas nenit 3, Paneli vuri në dukje konsideratat dhe rrethanat e mëposhtme:
 - i. Trauma dhe frika e viktimës ishte reale dhe e vërtetë;
 - ii. Cenueshmëria e ankueses si dëshmitare dhe viktimë e krimeve të rënda;
 - iii. Frika dhe shqetësimi - i njohur për Misionin - se ajo ndjeu se duhej të dëshmonte për ato krime dhe, për më tepër, ta bënte këtë në Serbi;
 - iv. Mungesa e qartësisë dhe transparencës në lidhje me shpërndarjen e përgjegjësisë për sigurinë dhe mirëqenien e ankueses përderisa ishte në Serbi;
 - v. Dështimi i Misionit për të kryer një vlerësim të rrezikut ose/dhe për të siguruar që një i tillë ishte kryer nga autoritetet vendore;
 - vi. Dështimi i Misionit për të hetuar me zell a) pretendimet e kërcënimeve në Serbi dhe b) pretendimet e kërcënimeve në Kosovë;
 - vii. Dështimi i Misionit për t'u angazhuar plotësisht në lidhje me shqetësimet e ankueses dhe për ta lënë atë, që në vend të kësaj të kërkonte mjete juridike korrigjuese dhe mbrojtje vetë. (Shih 2019-01, *G.T. kundër EULEX-it*, 11 dhjetor 2020, paragrafët 85-86).

III. VLERSIMI PASUES NGA PANELI SIPAS RREGULLËS 45 E TUTJE

26. Rekomandimi i parë i Panelit ishte që Misioni të pranonte që sjellja e tij kishte kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit.

27. Misioni nuk ka arritur të adresojë këtë rekomandim.
28. Prandaj, Paneli do të përsërisë rekomandimin e tij që Misioni të njohë kontributin e sjelljes së tij në shkeljen e të drejtave të ankuesit. Paneli ka theksuar në një numër vendimesh që njohja e shkeljes së të drejtave të njeriut mund të jetë një masë e rëndësishme dhe domethënëse për ankuesin. Gjithashtu është një mënyrë që Misioni të 'bëjë korrigjimin', pjesërisht, në lidhje me mosrespektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të ankuesit.
29. Rekomandimi i dytë i Panelit ishte që Misioni të kontaktojë ankuesin dhe autoritetet vendore për të vërtetuar nevojën për siguri shtesë që del nga dëshmia e ankuesit në Serbi.
30. Misioni informon Panelin se, në përputhje me rekomandimet e Panelit, ai ishte takuar në shkurt 2021 me Policinë e Kosovës duke i informuar ata për ankesën dhe shqetësimet e ankuesit. Misioni deklaron se ka marrë siguri se shqetësimet e ankuesit do të adresohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Misioni deklaron se më vonë atë muaj u informua se Policia e Kosovës kishte vizituar ankuesen në adresën e saj të shtëpisë dhe

‘iu ofrua siguri se çdo kërcënim që ajo do t’u raportonte atyre në të ardhmen do të hetohej siç duhej dhe se çdo shqetësim për sigurinë e saj do të adresohet siç duhej. [Ankuesi] mori informacion të qartë se si dhe me kë të kontaktojë në Policinë e Kosovës’.

Misioni deklaron se në mars 2021 kishte bërë një vizitë të dytë në Policinë e Kosovës për të konfirmuar informacionin e marrë përmes telefonit.

31. Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të dytë, Paneli vënë re dhe përgëzon Misionin për hapat e ndërmarrë në lidhje me ndërlidhjen me Policinë e Kosovës për shqetësimet e sigurisë së ankuesit. Paneli megjithatë vëren se Misioni duket se nuk ka arritur të kontaktojë ankuesen drejtpërdrejt për të kërkuar pikëpamjet e saj mbi nevojën për siguri shtesë. Paneli thekson se ishte Misioni ai e kishte kontaktuar në mënyrë aktive ankuesen në 2019 në lidhje me udhëtimin e saj në Serbi për të dhënë dëshmi. Misioni pas kësaj e shoqëroi ankuesen në Serbi dhe ishte, sipas gjetjeve të Panelit, përgjegjës për sigurinë e saj brenda kufijve të Kosovës. Paneli shpreh keqardhje që Misioni tani nuk do t’a kontaktojë ankuesin për t’ia përcjellë shqetësimet e sigurisë që sjellja e tij e pjesërisht kishte kontribuar në të.
32. Në bazë të asaj që u përmend më sipër, Paneli konstaton se Misioni ka zbatuar vetëm pjesërisht rekomandimin e dytë të Panelit dhe fton Misionin të kontaktojë ankuesen drejtpërdrejt, për të vërtetuar nevojën për siguri shtesë që del nga dëshmia e saj në Serbi.
33. Paneli gjithashtu kërkoi nga Misioni që t’ia shpërndajë këtë vendim zyrtarëve përkatës të Misionit dhe autoriteteve jashtë tij.
34. Misioni thekson se të gjitha vendimet e Panelit ‘iu dërgohen pa vonesë njëjësive përkatëse të Misionit, dhe në përputhje me OPLAN-in ato transmetohen nga EULEX-i tek komandanti i Operacioneve Civile brenda Kapacitetit të Planifikimit dhe Veprimeve Civile’.
35. Paneli merr parasysh deklaratën e Misionit dhe konstaton se në lidhje me këtë ajo ka qenë në përputhje me kërkesën e Panelit.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

GJEN se Misioni ka ndjekur dhe zbatuar disa, por jo të gjitha rekomandimet e Panelit;

GJEN se shefi i Misionit nuk ka arritur të adresojë rekomandimin e Panelit për të pranuar shkeljen e të drejtave të ankesës nga Misioni, dhe e **FTON** atë të bëjë një pranim të tillë;

SHPEH KEQARDHJE për dështimin e Misionit për të njohur shkeljen e të drejtës së ankueses,

GJEN se Misioni nuk ka arritur të kontaktojë ankuesen drejtpërdrejt në lidhje me përcaktimin e nevojës për siguri shtesë që del nga dëshmia e ankueses në Serbi, dhe e **FTON** Misionin ta bëjë këtë;

SHPEH KEQARDHJE për dështimin e Misionit për të kontaktuar ankuesen drejtpërdrejtë pas lëshimit të rekomandimeve të Panelit;

KËRKON NGA MISIONI që t'ia shpërndajë këtë vendim zyrtarëve përkatës të Misionit dhe autoriteteve jashtë tij;

E MBAN KËTË lëndë të hapur deri në njoftimin tjetër;

PËRFUNDIMISHT, PANELI KONSTATON që përgjegjësia për të siguruar një mjet efektiv juridik për shkeljet e të drejtave të kryera nga Misioni është dhe mbetet plotësisht tek vetë Misioni. Në masën që Misioni, përmes shefit të Misionit, nuk është në gjendje ose nuk dëshiron t'i zbatojë plotësisht rekomandimet korrigjuese të Panelit, mbetet përgjegjësia e tij për të gjetur mjete dhe metoda alternative të lehtësimit që sigurojnë një mjet efektiv juridik për shkeljet që konstatohet se janë kryer;

FTON shefin e Misionit të adresojë kërkesat e Panelit jo më vonë se data 20 gusht 2021.

Për Panelin,

Guénaél METTRAUX
Kryesues

Petko PETKOV
Anëtar zëvendësues

Anna AUTIO
Anëtare